



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:090921 C. nr. 1014/2020  
Datë: 17.05.2021  
Numri i dokumentit: 01782472

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha me praktikanten Meleke Muhameti, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS) kundër të paditurit H.(B.)G. nga Prizreni, Rr. “.....” ort....., për kompensim dëmi, jashtë seance me datë 17 maj 2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M  
(Në bazë të padëgjueshmërisë)

Miratohet kërkesëpadia e paditëses KEDS, me seli në Prishtinë.

Detyrohet i padituri H.(B.)G nga Prizreni, që paditëses KEDS me seli në Prishtinë, në emër të dëmit të shkaktuar me kamat vjetore 8%, nga data 3 gusht 2020 (datë e parashtrimit të padisë) t'i paguan paditëses shumën 261.47€. si dhe të kompenson shpenzimet e procedurës me shumën 20,00€ , të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 3 gusht 2020 ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadiisë në atë mënyrë që të detyrohet i padituri H.(B.)G të paguan shumën 261.47 € në emër të dëmit të shkaktuar.

Në padinë e paraqitur, paditësja paraqet prova se me Aktgjykim P.nr.1521/18 datë 21 tetor 2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 6 nëntor 2019, i padituri H.(B.)G është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal të Kosovës.

Sqarojnë se sipas llogaritjes që kanë bërë dhe atë sipas faturës për rikthimin e humbjeve vlera e dëmit që i është shkaktuar paditëses është 261.47 €.

Gjykata një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë i ka dorëzuar palës së paditur me vërejtje për dhënien e përgjigjes në padi, duke e udhëzuar palën e paditur që të paraqet përgjigje me shkrim në padinë e palës paditëse. Ndërsa në anën tjetër edhe e ka njoftuar për pasojat e mosveprimit sipas asaj vërejtje.

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi si dhe duke pasur parasysh faktin se themelësia e kërkesë padisë del nga faktet e treguara në padi dhe të njëjtat nuk

janë në kundërshtim me provat e bashkangjitura padisë, gjykata në kuptim të nenit 150 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjithashtu bazë për miratimin e kërkesëpadisë, gjykata e vlerësoi dëmin të cilin i është shkaktuar palës paditëse me kryerjen e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, si dhe faturës për rikthimin e humbjeve. Ashtu siç e përcaktohet edhe me nenin 135 par.1 lidhur me nenin 169 par. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që edhe miratoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma prej 261.47 €, është reale sipas llogaritjes së bërë e cila është në përputhje me nenin 31 par. 1 dhe 2 të Rregullave për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Gjykata vendosi që pala e paditur të paguan kamatën vjetore prej 8 % nga data 3 gusht 2020 deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke miratuar shumën prej 20,00 € për taksa gjyqësore për padinë e paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
C. nr. 1014/2020 datë 17 maj 2021

Praktikantja  
Meleke Muhameti

Gj y q t a r i:  
Atdhe Berisha

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.